



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 847/1 Prot.

Tiranë, më 29 / 6 /2018

V E N D I M

Nr. 143, Datë 29 / 6 / 2018

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 88, datë 13.06.2018, të paraqitur nga B.Z kundër Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, FSDKSH dhe Drejtorisë Rajonale të FSDKSH, Kamëz-Vorë në të cilën pretendon diskriminim për shkak të “bindjes politike”, “gjendjes martesore” dhe “gjendjes familjare”. Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga B.Z, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Sipas informacionit të dhënë, në formularin e ankesës, subjekti ankues deklaroi se, në datë 20.04.2018 është njohur me Urdhrin nr.33, datë 20.04.2018 “Për ndërprejten e marrëdhënieve të punës” me Drejtorinë Rajonale Kamëz-Vorë, për moskryerje të detyrave funksionale pa shkaqe të arsyeshme dhe në mënyrë të përsëritur. Ankuesja shpjegon se me Urdhrin nr. 1123/1, datë 12.03.2018 është transferuar nga Drejtoria e Përgjithshme e FSDKSH në Drejtorinë Rajonale Kamëz-Vorë pasi Drejtori, E.D i kishte thënë se do bëhen shkurtime dhe ankuesja ka pranuar transferimin. Me Urdhrin e Brendshëm nr.31, datë 03.04.2018 është njoftuar nga Drejtoria Rajonale Kamëz-Vorë për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje” për pasaktësi në dërgimin në drejtorinë e përgjithshme të evidencës javore të Check-up-it si dhe evidencës së performancës së QSH-ve për muajin Shkurt 2018. Me Urdhrin nr.32, datë 19.04.2018 është njoftuar për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje” për mospërbushje të urdhrit të Përgjegjësit të Sektorit për marrjen në dorëzim nga Sektori i Rimbursimit të dosjeve të farmacive të 15 ditëshit të dytë të muajit Mars 2018. Ankuesja shpjegon se i është bërë padrejtësi pasi largimi i saj nga puna është bërë në kundërshtim me Kodin e Punës dhe dhënia e masave disiplinore kanë qenë të padrejta dhe të pabazuara në fakte dhe në Rregulloren e funksionimit të FSDKSH-s. B.Z informon se ka 16 vite pune pranë FSDKSH-s dhe 7 vite punë në institucione të tjera në profesionin si ekonomiste dhe nuk ka patur asnjëherë vërejtje nga eprorët duke kryer me korrektësi detyrat e ngarkuara. Subjekti

ankues¹ pretendon se shkak për largimin e saj nga puna është bindja politike e bashkësorit të saj që është e kundërt me qeverinë aktuale.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe anulimin e masave disiplinore.

Duke qenë se shpjegimet dhe dokumentacionet e dhëna prej ankuseses ishin të paqarta në lidhje me shkakun e pretenduar dhe lidhjes shkakësore ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur, zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me email-in datë 14.06.2018 ka kërkuar nga subjekti ankues shpjegime, fakte dhe prova për të provuar shkaqet e pretenduara për diskriminim.

Me email-in datë 14.06.2018, subjekti ankues ka informuar se, është thirur në zyrë nga Drejtori i Drejtorisë E.D i cili i ka kërkuar të firmos kërkesën për transferim në Drejtorinë Rajonale Kamëz-Vorë, me arsyen se do të zëvendësohej pozicioni i saj si ekonomiste, me një person tjetër që mund të ishte farmacist. Ankuesja shprehet se ka pranuar transferimin sepse nuk donte që të ngelej pa punë, pasi është kryefamiljare me 3 fëmijë, por arsyeja e zëvendësimit nuk ka qenë e vërtetë sepse vendi i punës i saj jo vetëm që nuk është shkurtuar por janë marrë dhe dy ekonomistë të tjerë nga Drejtoritë që do shkriheshin, S.Ç dhe Dh.G. Ankuesja informon se, drejtuesja e Drejtorisë Rajonale Kamëz-Vorë nuk ka marrë masë disiplinore për përgjegjësit, të cilët janë ekonomistja A.M dhe Përgjegjësi i Sektorit R.M.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyrë më pak të favorshme për shkaqet e parashikuara në ligj, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur. Ankuesi në rastin në fjalë nuk ka paraqitur prova, lidhur me shkakun e diskriminimit.

Ankuesja në rastin në fjalë, ka paraqitur informacion lidhur me procedurën e largimit nga puna, por nuk ka paraqitur fakte dhe prova apo shpjegime për të provuar shkakun e diskriminimit të

¹ Me emailin datë 14.06.2018 në përgjigje të kërkesës për plotësim dokumentacioni të dërguar nga zyra e Komisionerit, B.Z ka shpjeguar se: *“Arsyeja e vetme, mund të jetë ngaqë bashkëshorti ka bindje të kundërta politike me këta në pushtet, rasti i tij dihet drejtor i PD dhe nuk e la detyrën kur erdhi PS, këta e burgosën pa asnjë fakt në vitin 2013, doli i pafajshëm, dhe pas 2 vitesh me urdhër të Ministrisë iu bë prap gjyq dhe i dhanë 3 vjet pa asnjë provë”.*

pretenduar dhe për të provuar se largimi i saj nga puna është bërë për shkak të “bindjes politike”, “gjendjes martesore” dhe “gjendjes familjare” apo cilësive të veçanta që ankuesja ka.

Ankuesja lidhur me pretendimin për diskriminim për shkak të “bindjes politike”, “gjendjes martesore” dhe “gjendjes familjare”, shprehet se arsyeja është se: “*Bashkëshorti i saj ka bindje të kundërta me pushtetin pasi ka qenë drejtor gjatë qeverisjes së mëparshme dhe se është burgosur që në vitin 2013*”, Komisioneri vlerëson se që në periudhën prej muajit Tetor 2013 deri më sot, institucioni i FSDKSH drejtohet nga drejtues të zgjedhur nga subjektet politike fitues të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2013 dhe për këtë arsye nuk ekziston një justifikim i mundshëm për të legjitimuar shkakun e pretenduar pas një periudhe 5-vjeçare të marrëdhënieve të punësimit.

Referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “*Ankesa nuk pranohet nëse nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim*”, ankesa nuk mund të pranohet.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/ç dhe 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së B.Z, për shkak se nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

Robert GAJDA

KOMISIONERI